



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe neni 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-392, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2021, merr këtë

VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE
"PRANVERA SHQIPTARE '81"

- I. Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore "Pranvera shqiptare '81".
- II. Lokacioni nga pika I e këtij vendimi, caktohet në oborrin e Mensës së Studentëve, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban "Prishtina 2012-2022", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale, nr. 7424-2, ZK, Prishtinë.
- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë skicat e lokacionit të cekur në pikën II të këtij vendimi.
- IV. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorja e Financave dhe Drejtorja e Kadastrit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-353/01-27290/21, më 11.02.2021

KRYESUES I KUVENDIT
Agim Kuleta



A r s y e t i m

i Vendimit për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore “Pranvera shqiptare ‘81”

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka shqyrtuar kërkesën më nr. 14 - 070/01-171513/20, të dt. 22.09.2020, nga këshilli organizativ për shënimin e 40-vjetorit të Pranverës Shqiptare '81, drejtuar Kryetarit të Komunës, për caktimin e lokacionit për vendosjen e pllakës përkujtimore “Pranvera shqiptare ‘81”. Bazuar në përmbajtjen e kësaj kërkesë, kushtuar lëvizjes studentore të pranverës së vitit 1981 në Prishtinë, kërkohet të vendoset pllaka përkujtimore në oborrin e Mensës së Studenteve në Prishtinë.

Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, sipas kërkesës së lartcekur, në bashkëpunim me zyrtarët e kësaj drejtorie, ka identifikuar lokacionin për vendosjen e pllakës përkujtimore kushtuar lëvizjes studentore të vitit 1981, i cili gjendet në kuadër të Planit zhvillimor urban “Prishtina 2012-2022”, i miratuar me Vendimin e KK të Prishtinës, 01, nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, sipas të cilit kjo zonë është paraparë hapësirë për përmbajtje publike dhe hekurudhën e propozuar në afërsi.


Lokacioni i propozuar shtrihet në pjesën e parcelës kadastrale nr. 7424-2, ZK, Prishtinë, në pronësi të Komunës së Prishtinës.

Pllaka përkujtimore “Pranvera shqiptare ‘81”, është propozuar të vendoset në oborrin e Mensës së Studenteve, dhe në aspektin e planifikimit nuk paraqet ndonjë pengesë për caktimin e lokacionit sipas kërkesës së lartcekur.

Bazuar në gjendjen faktike, konstatojmë se hapësira ku do të vendoset pllaka përkujtimore “Pranvera shqiptare ‘81”, është sipërfaqe e gjelbëruar, andaj gjatë vendosjes duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ambientit dhe rregullimit të parterit, si dhe ruajtjes së gjelbërimit. Sa i përket madhësisë, formës dhe materialit të kësaj pllake përkujtimore do të përcaktohet në procedurat e mëtejme.

Bashkëngjitur:

Pamje nga “Geoportal Kosova”



Lokacioni i propozuar